

RAPORT SHNDERRIMI

Mbi riorganizimin dhe shndërrimin e shoqërisë SEGMENT në shoqëri aksionare.

Për Asamblenë e shoqërisë SEGMENT (në proces riorganizimi)

Baza ekonomike e riorganizimit.

Arsyetimi në lidhje me transformimin e kompanisë nga modeli I shpk (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar) në sha (shoqëri aksionare) lidhet me zhvillimin e Biznesit të kompanisë në një projekt me të plotë e kompleks, pas një eksperience 15 vjeçare në fushën e distribuimit të makinerive të renda të ndërtimit, në fushën e betonit, asfaltit, prodhim apo dhe makinerive për shfrytëzim të materialeve nëntokesore. Me kontrata kryesisht ekskluzive nga prodhuesit, me kohë të gjatë perfaqësimi, projekti duhet të jetë me I plotë dhe I kualifikuar.

Si rrjedhojë, përveç distribuimit dhe shitjes së këtyre makinerive është nevojë e vazhdueshme e mbajtjes së garancive, mirëmbajtjes të tyre në mënyrë kompetente dhe profesionale.

Duke qenë se personeli I kompanisë është I strukturuar, trajnuar në vend e jashtë, në disponojmë magazine me vlerë të konsiderueshme shitjesh për pjesë këmbimi licencimi I të gjitha këtyre shërbimeve teknik që përfshijnë konsulence dhe nderhyrje teknike është I nevojshëm.

Kompania gjithashtu kërkon të kyejë dhe gjithë praktikatat e nevojshme për marrjen e licencave në lidhje me shitjen e pjesëve të këmbimit për sektorin e makinerive të renda, servisit të tyre, shitje të makinerive dhe shitje për projekte të ngjashme me to. Paraqitja e dokumentacionit për një servis të specializuar në hapësirë, njerez, material e pajisje servisimi në këtë fushë.

Si e tillë, synohet në marrjen e një teresie licencash në shitje të vajrave industriale dhe lubrifikuesve, aditive dhe të tjera materiale në të ngjashme me to. Ushtimi i këtyre aktiviteteve është i normuar nga kuadri rregullator ligjor, i cili specifikon se forma ligjore e shoqërisë duhet të jetë ajo aksionare. Për këtë arsye, zhvillimi i aktiviteteve për të cilat është themeluar shoqëria bëhet i pamundur në rast se shoqëria nuk riorganizohet duke u shndërruar nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në një shoqëri aksionare.

Vendimi i transformimit duket i arsyeshëm dhe në përputhje me qëllimin e shoqërisë dhe parashikimet e tjera statutores.

Baza ligjore e riorganizimit.

Riorganizimi i shoqërisë do të bëhet në përputhje me ligjin Për Shoqëritë Tregtare dhe ligjin Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Nga organet ekzekutive të shoqërisë është hartuar Statuti i shoqërisë SEGMENT SHA, e cila do të jetë forma e re e shoqërisë pas riorganizimit. Ky Statut parashikon si vijon:

- Shoqëria SEGMENT SHA do të jetë një shoqëri aksionare me ofertë private me një nivel;
- Organet e shoqërisë SEGMENT SHA janë të parashikuara në nenet e Statutit;
- Kapitali aksionar i shoqërisë SEGMENT SHA do të jetë 10.000.000 lekë, i ndarë në 100 copë aksione të zakonshme me vlerë emërore 100.000 lekë secili. Vlera e kapitalit dhe pjesa e zotëruar nga aksionaret nuk do të ndryshojë me këtë transformim;
- Shoqëria nuk duhet të procedojë në shpërndarjen e dividendëve, pa plotësuar kërkesat e Statutit lidhur me rezervat ligjore;
- Riorganizimi i shoqërisë nuk sjell asnjë efekt të ri në marrëdhëniet dhe statusin e punëmarrësve të shoqërisë;
- Riorganizimi nuk sjell ndryshime në marrëdhënie me kreditorët aktualë të shoqërisë dhe shoqëria SEGMENT SHA që rezulton nga riorganizimi merr përsipër dhe trashëgon pa pretendime detyrimet aktuale të shoqërisë SEGMENT SHPK. Gjithsesi, kreditorët që kanë pretendime, mund të zbatojnë të drejtat që u jep ligji Për Shoqëritë Tregtare.

Konkluzione.

Shoqëria konsiderohet e shndërruar në momentin që organi vendimmarrës do të miratojë këtë raport dhe Statutin e përmendur në këtë raport. Vendimi i miratimit duhet depozituar në regjistrin tregtar.

Shoqëria do të vijojë aktivitetin normalisht dhe bilanci i shoqërisë SEGMENT SHPK trashëgohet në shoqërinë SEGMENT SHA.

Në zbatimin e procedurave të riorganizimit nuk u hasën vështirësi të veçanta lidhur me vlerësimet.

Ajten Goci

Administrator

SEGMENT (në proces riorganizimi)

18 MAJ 2018

